



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 016-73328

Më datë 05.12.2025

Duke u bazuar në nenin 13, nenin 58, pika (f) lidhur me nenin 62 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" e në mbështetje të nenit 30, 45 paragrafi 1 pika (d) të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336, i 04.11.2008, Kryetari i Komunës në Suharekë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Besa KUQI**- Lirohet nga pozita e Drejtoreshë të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Suharekës, për shkak se në zgjedhjet lokale 2025, është zgjedhur anëtare e Kuvendit të Komunës në Suharekë.
2. Obligohet zyra e personelit pranë Komunës së Suharekës, që të lartë përmendurën ta heq nga lista e pagës nga data 08.12.2025.
3. E lartpërmendura, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pas largimit nga funksioni është e obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me nenin 10, të Ligjit Nr. 04/L-050, për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga, Kryetari i Komunës të Suharekës dhe e shfuqizon vendimin me numër 01-Nr-016-39148 i datës 30.06.2022.



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Kopje:
Drejtori Drejtorisë
Zyra e personelit
Arkiva